



Schools: Retain this completed form for your records

Pëlqimi për M.F. Monitori i Jashtëm për të Vëzhguar Mbledhjen e Ekipit 504

Në pranverën e vitit 2023, Departamenti i Arsimit i NYC (NYC Department of Education – DOE) hyri në një marrëveshje zgjidhjeje për të mbyllur një padi që lidhej me kujdesin dhe shërbimet për diabetin në shkollat publike të DOE-së. Më shumë informacion rreth çështjes (M.F., et al. v. DOE, et al.) gjendet në faqen zyrtare të DOE: <https://www.schools.nyc.gov/school-life/health-and-wellness/staying-healthy/diabetes>

Si pjesë e marrëveshjes, një Monitorues i Jashtëm do të vëzhgojë një numër mbledhjesh të Ekipit 504 për të parë si po funksionon procesi i Seksionit 504 për nxënësit K-12 të DOE-së me diabet. Monitoruesi i Jashtëm vetëm do të dëgjojë dhe vëzhgojë, nuk do të marrë pjesë në mënyrë aktive në mbledhje. Ata do të përdorin vëzhgimet për t'i dhënë DOE-së komente se si mund të përmirësojë procesin e Seksionit 504 për nxënësit dhe familjet e tyre.

Ju lutemi plotësoni këtë formular nëse jepni pëlqimin që Monitoruesi i Jashtëm dhe/ose një anëtar i ekipit të tyre të marrë pjesë në Mbledhjen e Ekipit 504 të fëmijës suaj. DOE do t'i ruajë formularët e pëlqimit deri më 15 gusht 2026, ose deri në fund të periudhës së marrëveshjes. Megjithatë, ju mund ta tërhiqni pëlqimin në çdo kohë duke kontaktuar Koordinatorin 504 në shkollën e fëmijës suaj.

Unë, _____ (Prind/kujdestar, ose nxënës nëse është i emancipuar (që i është dhënë liri nga prindi legalisht ose mbi 18 vjeç)), jap pëlqimin për pjesëmarrjen e Monitoruesit të Jashtëm/përfaqësuesit të tij në mbledhjen e Ekipit 504 për mua/për fëmijën tim.

E kuptoj që Monitoruesi i Jashtëm/përfaqësuesi i tij do të mësojë informacione që lidhen me akomodimet dhe shërbimet shëndetësore për diabetin tim/të fëmijës tim, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së DOE-së me marrëveshjen M.F.

Emri i Nxënësit: _____

Shkolla: _____

Numri OSIS: _____

Nënshkrimi i Prindit/Kujdestarit: _____ Data: _____

Nënshkrimi i Nxënësit (nëse është i emancipuar ose mbi 18 vjeç): _____ Data: _____